



**Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE5)
Aplikacioni për Tarifa**

28 janar 2010

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 9</i>

1. Hyrje

Me datë 30 dhjetor 2010, KOSTT ka pranuar nga ZRrE njoftimin lidhur me planin e realizimit të shqyrtimit të pestë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE5) që ka të bëjë me tarifën dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2010.

Me këtë dokument dhe dokumentet tjera përcjellëse KOSTT paraqet në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Aplikacionin për Ngarkesat dhe Tarifën për operatorin e sistemit, transmissioinit dhe tregut të vitit 2011.

Aplikacioni për tarifa për vitin 2011 shoqërohet edhe me paraqitjen e vështirësive dhe paqartësive lidhur me trajtimin e aseteve dhe paqartësive që janë ngritur lidhur me parametrat e realizuar të balancës së energjisë elektrike si rrjedhim i ndryshimeve në mes të atyre të planifikuara si përcaktuese për tarifën si njësi, që përcaktojnë nivelin e të hyrave të realizuara, e që doemos paraqiten ndryshe me ato të lejuara nga ZRRE. Prandaj kësaj radhe, KOSTT paraqitet me dy propozime për tu konsideruar nga ZRRE gjatë procesit të SHTE5 të përcaktuar sipas shkresës nr.267/10.. të datës.30 dhjetor 2010.

Kërkesa për Të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 sipas variantit të parë d.m.th. me vlerën zero të aseteve para vitit 2006 është **€ 17,086.447** e cila është **6%** më e vogël se Të Hyrat e Lejuara të vitit 2010.

Kërkesa sipas variantit të dytë ku vlera e aseteve është konsideruar sipas dokumentit për rivlerësim të aseteve dërguar ZRRE-së me dt. 24.08.2010 është **€ 19,286.447** e cila është **6,6%** më e madhe se Të Hyrat e Lejuara të vitit 2010.

Pozicionet specifike janë sqaruar si më poshtë.

2. Trajtimi i Aseteve të KOSTT

Metodologjia e trajtimit të aseteve në proceset e shqyrtimit të tarifave vazhdon të paraqes ndikimin në krijimin e ulët të vlerës së bazës së aseteve të rregulluara. Praktika e pesë shqyrtimeve të tarifave ka treguar bindshëm se vendimi për barazimin e vlerës së të gjitha aseteve para vitit 2006 me zero, ka qenë joadekuat. Meqenëse baza e rregullimit ekonomik aktual janë asetet, atëherë e kuptueshme është se KOSTT, në bazë të analizave të vazhdueshme ka konstatuar se zgjidhja e vetme e problemit është ngritja e vlerës së aseteve para 2006 në nivelin e duhur. Ky konstatim i është vënë në dijeni ZRrE-së vazhdimisht në komunikimet dhe takimet e ndryshme dhe përfundimisht i është shprehur si qëndrim me datë 24 gusht 2010 në letrën e dërguar nga KOSTT (shih referencën). ¹

Kjo qasje e trajtimit të aseteve nga ZRrE ka rezultuar në një shpërndarje joadekuate të shpenzimeve, respektivisht vlera shumë të ulëta të shpenzimeve të amortizimit. Duke marrë parasysh se asetet e para 2006 janë në funksion, pavarësisht se trajtohen ndryshe, paraqitet nevoja e zëvendësimit të tyre, ku automatikisht KOSTT përballlet me vështirësi të financimit pasi që amortizimi është elementi tarifor që shfrytëzohet për zëvendësimin e aseteve. Vlera e ulët e aseteve nuk mundëson krijimin e të hyrave për zëvendësimin e tyre, kështu që KOSTT është përballur me vështirësi të shumta për sigurimin e këtyre fondeve. Një pjesë e tyre është financuar nga pjesa e mirëmbajtjes që është dedikuar për ripërtëritjen e infrastrukturës, por nga kjo praktikë ka lindur problemi i kapitalizmit të

¹ 100824_KOSTT_Rishqyrtimi i vlerës së aseteve të KOSTT



mirëmbajtjes që d.m.th. se këto asete nuk janë pranuar për rritjen e mirëfilltë të bazës së aseteve për shkak se janë financuar nga pagesat për ripërtëritjen e infrastrukturës.

Vizioni i KOSTT për zgjidhjen e këtij problemi i cili vazhdon të sillet në rreth është që vlera e aseteve të para 2006 të kthehet në nivelin që ka qenë para shlyerjes së bërë me 31 dhjetor 2004, pra, 112 mil.€. KOSTT është i vetëdijshëm se deri më tani nuk është paraqitur ndonjë obligim kreditor për këto asete prandaj edhe kërkon që trajtimi i tyre të bëhet në formën e donacioneve d.m.th. për këtë vlerë kërkon vetëm mbulimin e shpenzimeve të amortizimit. Për të realizuar këtë vizion KOSTT çdo vit e ka zvogëluar kërkesën për shpenzimet e mirëmbajtjes ashtu siç edhe sqarohet më poshtë në këtë pozicion.

Për arsyet e lartpërmendura KOSTT ka vendosur të paraqes dy aplikacione, pra dy versione të Modeleve Tarifore. Në njërin model është aplikuar vlerësimi i aseteve të para 2006 me 112 milion €, është zvogëluar mirëmbajtja në € 1,361.000 dhe rezultati na paraqitet me një rritje simbolike të kërkesës për Të Hyrat e vitit 2011 për 6.6% ndaj Të Hyrave të Lejuara të vitit 2010.

3. Balanca e Energjisë Elektrike

Në praktikën e deritanishme për llogaritjen e tarifave të transmisionit (në të njëjtën mënyrë zbatohet edhe për llogaritjen e tarifave të rrjetit të shpërndarjes dhe atyre të konsumatorëve fundor), parametrat e balancës si prodhimi, importi, energjia e shpenzuar dhe fuqitë maksimale janë marrë për të përcaktuar tarifën e veçanta për shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit. Më saktësisht, të hyrat e kalkuluar mbi bazën e shpenzimeve operative dhe atyre kapitale janë vënë në raport me parametrat e balancës (energjia dhe fuqia).

Mirëpo, praktikën e deritashme tregojnë se parametrat balancues në realizim, që në vlera ndryshojnë nga ato të planifikuara, të cilat janë me ndikimin në realizimin e të hyrave me vlera ndryshe nga ato të lejuara. Këto të hyra, kanë qenë më të mëdha, duke filluar nga të hyrat e realizuara nga konsumatorët fundor (tarifor), të hyrat e realizuara të rrjetit shpërndarës deri tek të hyrat për shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit. KEK-u ka ngritur shqetësimin e vet lidhur me këtë dhe si veprim arbitrar ka kthyer faturat e muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2010 të lëshuara nga KOSTT për shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit dhe refuzon pagesën e tyre mbi vlerën nominale të hyrave të lejuara nga ZRRE-ja.

Prandaj, në aplikimin që KOSTT ia dërgon ZRRE-së, parametrat e balancës të paraqitura ndryshe nga ato të miratuara, duke i konsideruar se janë me një saktësi më të lartë dhe shumë më afër me ato që pritet të realizohen. Metodologjia e shfrytëzuar për këtë përcaktim është ajo gjetjes së mesatareve nga realizimet e tre viteve të fundit, ashtu si është dashur të zbatohet edhe nga KEK-u gjatë planifikimit të ngarkesave në dokumentin e balancës së energjisë elektrike për 2011.

Në vazhdim, janë paraqitur të dhënat e realizuara për vitet 2008, 2009 dhe 2010 nga të cilat janë nxjerrë statistikat, në bazë të cilave janë kalkuluar parametrat e balancës të vendosur edhe në aplikacionin e KOSTT-it.

Nëse i referohemi trendëve të prodhimit në tre vitet e fundit kemi një rritje mesatare prej **5,53%**. Meqenëse kapacitetet prodhuese të gjeneratorëve janë të limituar atëherë në vlerat për balancën që KOSTT ka adaptuar në aplikimin për tarifë kjo rritje nuk është konsideruar.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 9</i>

Për sa i përket energjisë në disponim në tri vitet e fundit kemi një rritje mesatare prej **4%** që është marr parasysh dhe konsumi sipas dokumentit të Balancës së Energjisë Elektrike për vitin 2011 është rritur me këtë përqindje. Detajet e trendëve janë të paraqitur në Tabelën 1. dhe Fig. 1. Për sa i përket 5 (pesë) vlerave maksimale(“piqeve”) analiza mund të shihet në tabelën Tabelen 2

Figura 1.




Tabela 1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2008, 2009, 2010

MWh

Muajt	2008			2009			2010		
	E planifikuar	E realizuar	%	E planifikuar	E realizuar	%	E planifikuar	E realizuar	%
TC Kosova A	987 252	1 239 042	125.50	1 480 050	1 466 116	99.06	1 410 360	1 739 815	123.36
TC Kosova B	3 420 468	3 302 388	96.55	3 131 400	3 389 289	108.24	3 238 194	3 270 605	101.00
Sh.A.Kosova Thengjilli	0	0		0	0		0	0	
HC Ujmani	76 000	54 442	71.63	76 000	87 438	115.05	68 000	113 861	167.44
HC Lumbardhi	26 661	21 652	81.21	25 202	32 214	127.82	23 728	36 083	152.07
Prodhimi	4 483 720	4 595 872	102.50	4 687 450	4 942 844	105.45	4 716 554	5 124 281	108.64
Devijimi		- 7 264			12 975			- 7 108	
Eksporti		295 696			274 015			279 206	
Importi	497 400	708 195	142.38	621 500	767 542	123.50	813 940	829 032	101.85
Energjia në disponim	4 981 120	5 015 635	100.69	5 308 950	5 423 396	102.16	5 530 494	5 681 215	102.73
Distribucioni	3 855 998	4 124 724	106.97	4 286 097	4 383 819	102.28	4 312 690	4 432 328	102.77
Ferronikeli	663 500	395 485	59.61	496 800	464 099	93.42	629 112	621 073	98.72
Trepça	86 300	20 794	24.10	28 200	21 119	74.89	29 000	21 217	73.16
Sharri	60 000	62 570	104.28	61 000	62 509	102.47	61 000	59 757	97.96
Mihjet,Kos.thengj.,TS Palaj,gjenerim konsum.e jasht.KEK, LP 290	105 300	198 585	188.59	132 000	314 096	237.95	145 580	328 785	225.85
Kërkesa neto	4 771 098	4 802 158	100.65	5 004 097	5 245 641	104.83	5 177 382	5 463 161	105.52
Humbjet në bartje	204 226	210 508	103.08	217 667	174 574	80.20	197 268	131 043	66.43
Kërkesa gjithsej	4 975 324	5 012 666	100.75	5 221 764	5 420 215	103.80	5 374 650	5 594 203	104.08
Ngarkesat maksimale (MW)	880	967	109.89	930	1072	115.27	1020	1156	113.33

	2008	2009	2010
Prodhimi I planifikuar	4 483 720	4 687 450	4 716 554
Prodhimi I Realizuar	4 595 872	4 942 844	5 124 281
Konsumi I Planifikuar	4 771 098	5 004 097	5 177 382
Konsumi I realizuar	4 802 158	5 245 641	5 463 161
Humbjet në bartje të planifikuara	204 226	217 667	197 268
Humbjet në bartje të realizuara	210 508	174 574	131 043
Ngarkesa e planifikuar MW	880	930	1020
Ngarkesa e realizuar MW	967	1072	1156

Tabela 2. Parashikimi i pikut për vitin 2011
PARASHIKIMI I PIKUT PËR VITIN 2011
MW

Nun	VI.të pik	VI.të pi	VI.të pik	VI.të pik	VI.mes.	2009/2008*	2010/2009*	2010*3,7	2010 me3,7%
1	975	967	1072	1158	1066	110.86	108.02	42.85	1201
2	933	963	1072	1158	1064	111.32	108.02	42.85	1201
3	913	961	1071	1126	1053	111.45	105.14	41.66	1168
4	913	961	1067	1126	1051	111.03	105.53	41.66	1168
5	912	959	1066	1112	1046	111.16	104.32	41.14	1153
6	912	958	1060	1112	1043	110.65	104.91	41.14	1153
7	908	957	1059	1101	1039	110.66	103.97	40.74	1142
8	908	952	1058	1091	1034	111.13	103.12	40.37	1131
9	908	952	1057	1088	1032	111.03	102.93	40.26	1128
10	904	952	1056	1085	1031	110.92	102.75	40.15	1125
11	902	951	1056	1085	1031	111.04	102.75	40.15	1125
12	900	950	1054	1081	1028	110.95	102.56	40.00	1121
13	899	950	1051	1079	1027	110.63	102.66	39.92	1119
14	899	946	1049	1079	1025	110.89	102.86	39.92	1119
15	897	944	1047	1078	1023	110.91	102.96	39.89	1118
16	897	944	1046	1078	1023	110.81	103.06	39.89	1118
17	897	944	1044	1078	1022	110.59	103.26	39.89	1118
18	896	944	1043	1076	1021	110.49	103.16	39.81	1116
19	896	944	1043	1072	1020	110.49	102.78	39.66	1112
20	896	943	1043	1068	1018	110.60	102.40	39.52	1108
21	896	943	1038	1068	1016	110.07	102.89	39.52	1108
22	895	943	1038	1067	1016	110.07	102.79	39.48	1106
23	894	942	1036	1066	1015	109.98	102.90	39.44	1105
24	893	940	1035	1065	1013	110.11	102.90	39.41	1104
VI.mes.						110.74	103.69	40.39	1132

5 Pika të pikut për 2011

1201
1168
1153
1142
1131
1159

4. Shpenzimet Operative

Buxheti i lejuar për KOSTT për shpenzime operative për vitin 2010 ka qenë € 15,053.086.

Aplikacioni i KOSTT për Shpenzimet Operative 2011 paraqet një shumë prej € 14,113.425 .Thënë ndryshe kërkesa për vitin 2011 është 7% më e vogël se sa ajo e lejuar për vitin 2010.

Në vazhdim janë dhënë detajet e Shpenzimeve Operative.

4.1. Mirëmbajtja

Qasja e KOSTT ndaj Shpenzimeve të Mirëmbajtjes në vazhdimësi ka qenë konform Metodologjisë së Tarifave të Sektorit të Energjisë Elektrike. Zakonisht 20% deri 30% e buxhetit të mirëmbajtjes është shpenzuar për mirëmbajtje të aseteve, kurse pjesa tjetër është shpenzuar për ripërtëritjen e infrastrukturës, ashtu siç e përcakton metodologjia tarifore. E njëjta situatë paraqitet edhe në vitin 2010, ku 24% e buxhetit të lejuar është shpenzuar në mirëmbajtje kurse pjesa tjetër për ripërtëritjen e infrastrukturës.

Sipas variantit të parë për të hyrat që kërkohen, vlera e aseteve para 2006 tentohet të vendoset në vlera të cilat mundësojnë një shpërndarje më të harmonizuar të kostove, ku vlerat e mirëmbajtjes i afrohen standardeve të sistemeve të transmissioinit në rajon. Me këtë bëhet eliminimi i sforcimeve në rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe ngritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve me investime kapitale(1.361,00 €) .

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-CLRR-032
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 9</i>

Varianti i dytë i referohet qëllimit të KOSTT që vazhdimisht ka synuar për të zvogëluar trendin e kërkesës për shpenzimet e mirëmbajtjes duke pritur se me kohë do të eliminohet pagesa për ripërtëritjen e infrastrukturës dhe do të zëvendësohet me ngritjen e shpenzimeve të amortizimit. Kjo do të ndodhte si pasojë e rivlerësimit të asetëve të para 2006. Kërkesa e KOSTT për shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2011 është € 2,361.000 ose 40% më e vogël se sa buxheti i lejuar për vitin 2010.

Variant i parë paraqitet si një veprim i cili në terma afatgjatë siguron një zhvillim të tarifave të transmissioinit me lëvizje të ngadalësuar.

4.2. Shpenzimet e Personelit

Në aplikacionin për tarifa të vitit 2011 KOSTT ka paraqitur kërkesën për shpenzimet e personelit në vlerë prej 2,878.351 €. Kjo paraqet një rritje prej 15.3%, në krahasim me vitin paraprak, ndërsa në vlerë rritja kapë shumën prej 382.882 €.

Sipas analizave të KOSTT-it, buxheti i shpenzimeve të personelit nuk i kalon suazat e praktikave ndërkombëtare. Një element shumë i rëndësishëm që ndikon në lartësinë e shpenzimeve të personelit është struktura kualifikuese në KOSTT, ku rreth 50% të stafit është me kualifikime superiore. Indeksi i çmimeve të konsumit poashtu është element i rëndësishëm që duhet të konsiderohet në këtë rast. Sipas të dhënave të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës ky indeks gjatë vitit 2010 ka rritje për 6.6 %.

Me që lokalet afariste të KOSTT-it, të cilat shfrytëzoheshin nga KEK-u, janë liruar në fund të vitit 2010, KOSTT gjatë janarit 2011 ka rekrutuar 25 punëtorë të ri. Kjo do të thotë se numri i punëtorëve është rritur në 239. Edhe me këtë rast, pjesëmarrja e stafit me kualifikime superiore në mesin e punëtorëve të rekrutuar, është mbi 50%.

KOSTT planifikon që në vitin 2011 të ketë 245 punëtorë, një pjesë e stafit që do të punësohet gjatë vitit 2011, është paraparë se do të jetë në funksion të rritjes së bazës së asetëve, që do të thotë se do të vazhdojë vëllimi i shtuar i punëve të cilat kryesisht janë të lidhura me mirëmbajtjen e objekteve dhe operimin e sistemit.

Angazhimi jashtë orarit i stafit ekzistues, do të jetë i domosdoshëm edhe gjatë vitit 2011 për shkak të kërkesave për mirëmbajtje të sforcuar me synim të rritjes së gatishmërisë së rrjetit transmetues ende të pa përfshirë në procesin e rehabilitimit gjithëpërfshirës si dhe implementimit dhe komisionimit të një numri të madh projektsh kapitale. Projektet më madhore në këtë drejtim janë: Paket Projekti Ferizaji 2, Projekti Prizreni 2, Linja Kosovë - Shqipëri, Projekti SCADA/EMS dhe telekomunikacioni, rindërtimi i fushave 400 kV në NS Kosova B etj. Kjo, natyrisht do të reflektohet edhe në ngritjen e shpenzimeve të personelit për angazhimin shtesë jashtë orarit.

4.3. Shpenzime tjera

Kërkesa për këto shpenzime për vitin 2011 paraqet një rritje që i referohet përfshirjes së një pozicioni të ri i planifikuar lidhur me sigurimin e Asetëve të KOSTT (obligim sipas Nenit 24 të licencës së OST) me vlerë 450.000 €. Hapja e pikave të reja për sigurim fizik të objekteve si rezultat e finalizimit të projekteve kapitale, ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të kësaj kategorie.

4.4. Shërbimet Ndihmëse

Kërkesa për të hyra për Shërbimet Ndihmëse mbetet e nivelit të njëjtë si në vitin paraprak meqenëse projekti i Rregullimit Frekuencë – Fuqi do të financohet nga KfW ku parashihet edhe vendosja e një regjimi të operimit me Shqipërinë gjë që pritet të realizohet deri fund të vitit. Aranzhimet komerciale të këtyre shërbimeve gjithashtu do të jenë subjekt të këtij projekti që pritet të realizohet gjatë vitit 2011. në mungesë të parametrave më të saktë të një kontrate tregtare jemi të prirë që kërkesa të mbetet e njëjtë si për vitin 2010.

4.5. Humbjet në Transmision

Sipas Shqyrtimit të Katërt Tarifor për vitin 2010, përqindja e humbjeve në transmision ka qenë 3.1%, ndërsa energjia e parashikuar në disponim ishte 5316.6 GWh. Si rezultat volumi i humbjeve të lejuara është paraqitur 166 GWh.

Energjia e matur në vitin 2010 tregon rrjedha më të mëdha se sa ato të parashikuara, respektivisht energjia në disponim gjatë vitit 2010 ka qenë 5590.2 GWh, çka rezulton në rritjen e volumit të humbjeve të lejuara në 175 GWh. Humbjet e matura në transmision gjatë vitit 2010 janë 128.3 GWh. Siç po shihet, KOSTT me një efikasitet të ngritur ka arritur t'i zvogëlojë humbjet në transmision ndaj atyre të lejuara për 46.7 GWh.

Kërkesa e KOSTT për humbjet në transmision të vitit 2011 është e bazuar në qasjen stimuluese të përcaktuar nga Metodologjia Tarifore. Volumi i kërkuar është 151.6 GWh. Kjo vlerë paraqet humbjet aktuale të vitit 2010 plus gjysmën e volumit të humbjeve të zvogëluara.

$$128.3 \text{ GWh} + \frac{1}{2} 46.7 \text{ GWh} = 151.6 \text{ GWh}$$

5. Shpenzimet Kapitale

Në aplikacionin për SHTE5, për realizimin e shpenzimeve kapitale KOSTT ka prezantuar në vlerë totale prej € 5,635.146, të financuara nga donatorët dhe KOSTT. Duhet konsideruar se në këtë aplikacion është bërë harmonizim/përshtatje e vlerave të projekteve shumëvjeçare të përfunduara dhe atyre në vazhdim gjë që ka rezultuar me ulje të vlerave reale për tu prezantuar në aplikacion

Për vitin 2011, KOSTT planifikon të realizojë projekte kapitale në vlerë € 24,926.430. Buxheti i donacioneve për këtë vit planifikohet të jetë € 20,080.730; kredi € 500.000, ndërsa financimi nga KOSTT € 4,345.700.

Me një dokument të veçantë është paraqitur lista e projekteve kapitale për vitet 2007-2011 me të dhënat nëpër vite të shpenzimeve kapitale.

(FUND I DOKUMENTIT)